



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA TEKNIKE-PROFESIONALE "ENVER QIRAXHI" POGRADEC

Nr. 128 Prot

Pogradec, më 01.03.2023

Lenda: Njoftim për vend të lire pune

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit": të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit";

Shkolla teknike- profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec, ju njofton krijimin e vendit të lirë për **pozicionin e nëndrejtorit të kultures profesionale:**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të forcës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti për nëndrejtor, që mbulon kulturën profesionale duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit "Master shkencor" (ose të barasvlershme), në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues I kualifikuar";
- c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së;
- d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit.

4. Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit të AFP-s.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- Librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive teknologjike e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën sekretarisë së Shkollës teknike-profesionale "Enver Qiraxhi", brenda datës 15/03/2023 .

**DREJTORI I SHKOLLËS
ANDON TEMO**

E-mail:profesionalepogradec@yahoo.com